



Datë: 07.11.2025

Numër Protokoli: 7241/2025

A.nr.1756/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1756/2025, të datës 03.10.2025, të parashtruar nga ankuesi P.N, nga Ferizaj, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.1756/2025, e datë 03.10.2025, e parashtruar nga ankuesi P.N.

A r s y e t i m

Ankuesi P.N (*tutje referuar ankuesi*), më datë 30.09.2025 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 03.10.2025, kundër Vendimit me numër referencës DS-811/2025, të datës 12.09.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.10.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*tutje referuar SKGJK*), ndërsa Këshilli më datë 17.10.2025 ka pranuar përgjigje, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 6540/2025 të datës 03.10.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Vendimin me numër referencës DS-811/2025, të datës 12.09.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së; Kërkesë e datës 04.08.2025; Akt Emërimit e ankuesit të datës 25.07.2025; Shkresën “Shënim Zyrtar” me shifër Gj.Nr.139/22 të datës 11.05.2022; E-mailin e datës 05.04.2022 dërguar nga A.B për S.S me korrespondencën e bashkangjitur; Kontratë pune e datës 13.06.2017; Zarf postar me kodin R8996396 i datës 30.09.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 10.10.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 17.10.2025.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi fillimisht sipas Kontratës së punës të datës 13.06.2017 ka themeluar marrëdhënien e punës në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në pozitën e punës “*Roje sigurimi*”, ndërsa sipas Aktit të Emërimit Nr.03/1491 të datës 25.07.2025, i njëjti që nga data 01.08.2025 mban pozitën e punës “*Zyrtar për të hyra*”, në kuadër të Zyrës për Buxhet dhe Financa në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Ankuesi me datë 04.08.2025 i është drejtuar Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me kërkesën për kompensim material, në mënyrë retroaktive me pretendimin se i njëjti që nga data 14.03.2022 e deri me datë 01.08.2025 pavarësisht faktit që ka qenë duke e ushtruar pozitën e arkëtarit, i njëjti është paguar me pagën e njëjti sikurse rojë-sigurim, me arsyetimin se i njëjti ka qenë duke e ushtruar pozitën e arkëtarit sipas shkresës zyrtare të lëshuar nga Administratori i Gjykatës.

Tutje, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 12.09.2025 përmes Vendimit me shifër DS-811/2025 e ka refuzuar kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se nuk ka pasur kërkesë nga Gjykata që zëvendësimi të bëhet konform nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, akt ndaj të cilit ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin se ka qenë duke e ushtruar pozitën e arkëtarit sipas shkresës zyrtare të lëshuar nga Administratori i Gjykatës, ndërsa pagën e ka marr sipas pozitës “*Roje-Sigurim*”.

Kolegji i Këshillit po ashtu nga shkresat e lëndës të ofruara nga palët në këtë procedurë administrative, konstatoi se përmes shkresës të quajtur “Shënim Zyrtar” të datës 11.05.2022 të nxjerrë nga Administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj, ankuesi ishte caktuar të kryej detyrat e arkëtarit nga data 14.03.2022 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, mirëpo akti në fjalë nuk ka përcaktuar askund terma të vendimmarrjes për sa kohë do të ushtrojë këtë pozitë ankuesi, gjegjësisht shkresa në fjalë në fakt ka vetëm elemente sqaruese apo konfirmues, mirëpo nuk mund të përcaktohet nga e njëjta se çfarë angazhimesh ka pasur ankuesi pas datës 11.05.2022, dhe madje akti në fjalë askund nuk përfshinë përcaktimet ligjore për caktimin e ushtruesit të detyrës sipas legjislacionin për shërbimin civil.

Kolegji i Këshillit, analizoi dhe mori për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 35 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë., 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si

ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni”, dhe po ashtu Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi para datës 27.05.2025 deri kur e ka nënshkruar aktin e emërimit nuk e ka pasur statusin e nëpunësit civil, respektivisht caktimi i tij në cilësi të ushtruesit të detyrës së arkëtarit bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi për zyrtarët publik, pasi që pozita që ka mbajtur “Roje-Sigurim” sipas Kontratës së punës të datës 13.06.2017, nuk hynë në kuadër të së njëjtës njësi organizative, çështje kjo e cila është parakusht që pozita në fjalë të ushtrohet më zëvendësues apo ushtrues detyre në mënyrë të ligjshme, prandaj ankesa e ankuesit dhe pretendimet e tij ankimore nuk gjejnë mbështetje ligjore në dispozitat e aplikuara si më lartë, dhe për pasojë ankesa e tij është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1756/2025, datë 07/11/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit P.N,
- Sekretariat të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm, dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.